




KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA
KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVO
TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO



Marrëveshje bashkëpunimi

Ndërmjet:

Këshillit Prokurorial të Kosovës

dhe

Administratës Tatimore e Kosovës

Tetor, 2020

Neni 1 Palët

- 1.1 Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) adresa në: Rr. "Luan Haradinaj" p.n. Prishtinë, e përfaqësuar nga z. Bahri HYSENI, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- 1.2 Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) adresa në: Rr. "Bill Klinton" p.n. Prishtinë, e përfaqësuar nga z. Ilir MURTEZAJ, Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës;

Neni 2 Qëllimi i Marrëveshjes

- 2.1 Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është ndërlidhja e sistemeve elektronike dhe shkëmbimi i të dhënave në formë elektronike në mes të KPK-së dhe ATK-së.
- 2.2 Të gjitha të dhënat nga ATK në Prokurori do të dërgohen në formë elektronike nga sistemet e tyre përkatëse për menaxhimin e rasteve dhe anasjelltas.

Neni 3 Përgjegjësitë e palëve

- 3.1 KPK dhe ATK obligohen në formimin e një grupi të përbashkët për përcaktimin dhe mënyrën e shkëmbimit të të dhënave nga sistemet elektronike.
- 3.2 Grupi i përbashkët ka për obligim përgatitjen e Procedurës Standarde të Veprimit (PSV), e cila përmban të dhënat të cilat do të shkëmbehen.

Neni 4 Nënshkrimi i PSV

Me përfundimin e procedurës standarde të veprimit për shkëmbimin e të dhënave, dhe me aprovimin e menaxhmentit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Administratës Tatimore e Kosovës, nënshkrimi i PSV do të bëhet nga udhëheqësit e Departamenteve të Teknologjisë Informative.

Neni 5 Kualiteti i të dhënave

Palët nënshkruese obligohen për saktësinë e të dhënave të cilat shkëmbehen në mënyrë elektronike mes dy sistemeve.

Neni 6

Mbajtja e takimeve

KPK dhe ATK, përkatësisht departamentet gjegjëse të Teknologjisë Informative, do të mbajnë takime të rregullta në rast të avancimit të sistemeve, me qëllim të njoftimit dhe mënyrës së shkëmbimit të të dhënave.

Neni 7

Konfidencialiteti i informacioneve

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje, garantojnë konfidencialitetin e çdo informacioni që administrohet dhe shkëmbehet nga sistemet, në pajtim me ligjin.

Neni 8

Mbikëqyrja e marrëveshjes

Vënia në zbatim e kësaj marrëveshjeje do të mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme nga udhëheqësit e Departamenteve të Teknologjisë Informative, duke përpiluar raporte të veçanta të cilat përcillen te menaxhmenti i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Neni 9

Faza kalimtare

- 9.1 Krahas shkëmbimit të të dhënave në formë elektronike nga sistemet, në të njëjtën kohë, për një periudhë të caktuar kohore e cila do të vlerësohen nga Institucionet, do të bëhet shkëmbimi edhe në formë fizike.
- 9.2 Shkëmbimi i të dhënave paralel fizik/elektronik bëhet me qëllim që të sigurohet që të dhënat e dërguara janë të sakta dhe stafi është duke përdorur sistemin në mënyrë të kënaqshme.

Neni 10

Plotësimet dhe ndryshimet

Palët mund të bëjnë plotësime dhe ndryshime të nevojshme të kësaj marrëveshjeje në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellët të paraqitur me shkrim.

Neni 11

Ekzemplarët e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje përgatitet në 2 kopje/ekzemplarë të së njëjtës përmbajtje, secila prej tyre nënshkruhet nga palët kontraktuese.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit, ndërsa do të zbatohet në momentin që sistemet elektronike të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës janë në përdorim.

Palët nënshkruese

Këshilli Prokurorial i Kosovës



z. Bahri Hyseni
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Datë: 07/10/2020

Administrata Tatimore e Kosovës



z. Ilir Murtezaj
Drejtore i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës

Datë: 07/10/2020